



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit

P- 008

Prishtinë, më 26 shkurt 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
26,27,28,29 SHKURT DHE MË 3 MARS 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhezair Murati**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 94 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se, në bazë të rregullave 6. 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare. Ndërkohë, janë paraqitur edhe dy kërkesa.

Njërën e ka paraqitur ministri Mahir Jagcillar, dhe tjetrën ministrja për Energjetikë dhe Miniera, Justina Pula.

Kryetari ftoi ministrin ta arsyetojë kërkesën.

Ministri **Mahir Jagcillar** kërkoi rirenditjen e pikave të rendit të ditë, përkatësisht pika e 29-të të radhitet pas pikës 16.

Kryetari ftoi ministren e Energjetikës dhe të Minierave ta arsyetojë kërkesën.

Ministrja **Justina Pula**, në emër të sponsoruesit, tha se e tërheq nga procedura e shqyrtimit Projektligjin për eficiencën e energjisë.

Kryetari i hodhi në votim kërkesat e paraqitura. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- shumica absolute,
Kundër----- 1,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi kërkesën që pika e 29-të të radhitet si pikë e 17 dhe atë që pika 25 – Shqyrtimi i Projektligjit për eficiencën e energjisë, të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, kërkoi që Projektligji për ndihmën shtetërore dhe Projektligji për tatimin në vlerën e shtuar t'i kthehen propozuesit – Qeverisë së Kosovës. Ai kërkesën e arsyetoi se këto projektligje janë përgatitur nga Qeveria e mëparshme dhe nuk është bërë asnjë ndryshim, andaj kanë nevojë të ripunohen dhe sërish t'i procedohen Kuvendit.

Kryetari kërkoi mendimin e Qeverisë lidhur me propozimin e Gani Kocit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, deklaroi se pajtohet me propozimin e deputetit Koci.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- shumica,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa (me pëlqimin e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave) që Projektligji për ndihmën shtetërore dhe Projektligji për tatimin në vlerën e shtuar t'i kthehen propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, propozoi që Kuvendi në seancën e sotme, si çështje të ngutshme, të diskutojë edhe për çështjen e sigurisë në vend.

Kryetari tha se propozimi duhet të parashtrohet me shkrim, në përputhje me rregullat procedurale të Kuvendit.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,

3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përfitim të ish zyrtarëve të lartë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat bujqësore Nr. 2003/9,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbarimore,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokontestimore,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë ,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës,
20. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përkrahjen materiale të familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave,
22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ushqimin,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
25. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
26. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për modifikimin gjenetik,
27. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën e vendosjes,
28. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira
29. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektionin bujqësor,
30. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme

Procesverbalet e seancave plenare të 15 (dy seanca), 17, 19 dhe 20 shkurtit 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, lidhur me shlyerjen e borxheve qytetarëve të Kosovës për shpenzimet e rrymës elektrike si shpërblim për mundin dhe sakrificën e bërë për Kosovën.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me gurthyesin, që thyen gurë mbi Shpellën e Mermerit në Lipjan.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me gjendjen e disa grupeve të gjykuara - pjesëtarë të UÇK-së, me nga 4 e 5 vjet burg, të cilët tashmë sa vite janë pa gjykime të plotfuqishme.

Përgjigjja mbeti për seancën tjetër, ngase ministrja **Nekibe Kelmendi** nuk ishte e pranishme në seancë.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi dy pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Pyetja e parë kishte të bënte me inicimin e procedurës për hartimin e Projektligjit me të cilin profesorëve të Universitetit u mundësohet të punojnë deri në moshën 70 vjeçare. Pyetja e dytë kishte të bënte me numrin e madh të studentëve që janë regjistruar në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Përgjigjja mbeti për seancën tjetër, ngase ministri **Enver Hoxhaj** nuk ishte i pranishëm në seancë.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa

Kryetari i informoi deputetët me kërkesën e Grupit Parlamentar të AKR-së dhe e hodhi atë në votim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----75,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti **Shkumbin Deamaliaj** zgjedhet anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Driton Tali.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë.

Zëvendëskryeministri, **Hajredin Kuçi**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se qëllimi i këtij projektligji është sigurimi i bazës ligjore për dhënien e përfitimeve ish-zyrtarëve të caktuar të lartë ku përfshihen Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Kryetari i Gjykatës Supreme. Ky projektligj do të zvogëlojë në mënyrë të dukshme numrin e paqartësive sa i përket ofrimit të privilegjeve për ish-zyrtarët e lartë.

Projektligji përcakton ish-zyrtarët e lartë që mund të marrin përfitime dhe mënyrën e përfitimit.

Projektligji është i strukturuar në 9 nene në të cilat parashihen: qëllimi i ligjit, përkufizimet, përfitimi monetar, personeli mbështetës, hapësira për zyra, mbrojtja apo sigurimi i ish- zyrtarëve të lartë, pastaj procedura për marrjen e përfitimit, procedura e ankimit, taksimit dhe hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në fund, zëvendëskryeministri Kuçi i ftoi deputetët ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzana Novobrdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

Ministri i Bujqësië, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Idriz Vehapi** tha se qëllimi i këtij projektligji është të rregullojë çështjet të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për mbrojtjen e bujqve për të siguruar koherencë dhe legjislacion për Ligjin për kooperativat e bujqve.

Arsyeja e nxjerrjes së këtij Projektligji është vendosja e një kornize themelore legjislative, e cila specifikon themelimin dhe regjistrimin e kooperativave të bujqve në baza kontraktuese nga persona fizikë dhe juridikë që merren me bujqësi dhe të cilët bashkëpunojnë në kooperativë me qëllim të përsosjes dhe të zgjerimit të veprimtarisë së tyre bujqësore.

Zbatimi i Ligjit nuk do të ketë implikime buxhetore.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha**, të cilat janë dhënë në transkript.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij Projektligji ka rëndësi të madhe për faktin se përdorimi i substancave eksplozive nga personat e paautorizuar paraqet rrezik të vazhdueshëm për qytetarët dhe vendin.

Qëllimi kryesor i këtij Projektligji është vendosja e rregullave ligjore lidhur me përdorimin civil të eksplozivëve.

Projektligji i rregullon çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin, tregtimin, importimin, eksportin, transitin, transferimin, deponimin, përdorimin dhe asgjësimin e eksplozivëve, si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Për zbatimin e këtij Projektligji nevojiten mjete buxhetore, por gjithashtu edhe krijohen të hyra për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të Komisionit për Siguri dhe Punë të Brendshme, **Rrustem Mustafa**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Shkumbin Demaliaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Gani Geci** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha**, si dhe deputetët: **Et’hem Çeku**, **Bahri Hyseni** dhe **Sala Berisha-Shala**, të cilat janë dhënë në transkript.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, tha se nevoja për miratimin e këtij projektligji është se në Kosovë kjo fushë është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2, e plotësuar me Rregulloren nr. 2005/9, e cila ka mjaft mangësi. Projektligji është gjithëpërfshirës dhe i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Projektligji përmban gjithsej 16 kapituj dhe ka 34 nene.

Qëllimi i këtij projektligji është që të krijohet një infrastrukturë ligjore për identifikimin e saktë të klientëve dhe për një raportim të çdo transaksioni të dyshimtë për pastrimin e parave, e gjithë kjo në funksion të parandalimit, të zbulimit, të luftimit dhe të pastrimit të parave të fituara nga aktivitetet kriminale.

Organi kompetent të i cili duhet të raportohet është Njësia për Parandalimin e Pastrimit të Parave pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Naser Osmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxheri** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha**, si dhe deputeti **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript.

Në vazhdim seancën e kryesoi **Xhezair Murati**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Noterinë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjit për Noterinë.

Në emër të Qeverisë së Kosovës zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, tha se Projektligji për Noterinë rregullon një fushë, e cila deri më tani i ka munguar sistemit juridik të Kosovës.

Projektligji ka rëndësi të veçantë për faktin se me nxjerrjen e tij gjykatat do të lirohen nga një pjesë e punës, e cila ka të bëjë kryesisht me autorizimet e ndryshme, siç janë: vërtetimi i kontratave të ndryshme, vërtetimi i dokumenteve të ndryshme, i testamenteve, vërtetimi i dokumenteve dublikate në bazë të atyre origjinale etj.

Rëndësia e Projektligjit qëndron edhe në faktin se natyra e punëve me të cilat rregullohen çështjet eaktuara është nga fusha e çështjeve të marrëdhënieve jokontestimore.

Projektligji është i harmonizuar me ligjet që zbatohen në sistemin e avancuar të drejtësisë evropiane.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për Noterinë dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Agim Veliu**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzana Novobërdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Bajram Kosumi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, si dhe deputetët **Riza Smaka** dhe **Gjylnaze Sylja**, të cilat janë dhënë në transkript.

Keyesuesi, në mungesë të ministrave të Qeverisë së Kosovës për t'i prezentuar projektligjet para deputetëve të Kuvendit, dha pauzë në orën 13:15 minuta.

Seanca i vazhdoi punimet në orën 16:00

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari kërkoi nga Qeveria t'i obligojë ministrat që të jenë të pranishëm në seancë për t'i prezentuar projektligjet.

Kryetari i njoftoi deputetët se seanca do t'i zhvillojë punimet me orar të ri. Debati për shqyrtimin e projektligjeve zhvillohet prej orës 10:00 deri në orën 14:00. Pauzë për drekë prej orës 14:00 deri 16:00. Në orën 16:00 seanca i vazhdon punimet me votimin e projektligjeve që janë shqyrtuar para dite.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----73,
Kundër-----2,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për përfitimin e ish- zyrtarëve të lartë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----78,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, atë për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----77,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, atë për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----80,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi dhe atë për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për Noterinë**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi në parim, Projektligjin për Noterinë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për Noterinë brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e sotme, në orën 16:25 minuta.

E mërkurë, më 27 shkurt 2008
Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit,

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 70 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se ky projektligj ka rëndësi të veçantë që synon vendosjen e një kornizë adekuate ligjore dhe të vetme për mënyrën e pranimin të fajësisë së të akuzuarit përmes lidhjes së një marrëveshje proceduralo-penale me shkrim në mes të palëve dhe mundësisë së shqiptimit të dënimit më të butë nga ana e gjykatës.

Qëllimi i këtij Projektligji është sigurimi i një baze ligjore për futjen e një instituti të ri juridik në Kodin e përkohshëm penal të Kosovës, mbi pranimin e fajësisë i cili synon shqiptimin e dënimit më të butë për të akuzuarin, i cili ka lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Projektligji rregullon dhe qartëson në mënyrë të detajuar kushtet dhe kriteret për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, mënyrën e prishjes së marrëveshjes, si dhe mundësinë që gjykata të shqiptoj dënim më të butë duke u bazuar në këtë marrëveshje

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhanë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Bajram Kosumi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Müferra Şinik**, si dhe deputetët: **Hydajet Hyseni**, **Mark Krasniqi**, **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se ky Projektligj ka rëndësi të veçantë, i cili synon të vendos një kornizë adekuate ligjore dhe të vetme për mënyrën e pranimin të fajësisë së të akuzuarit përmes të lidhjes së një marrëveshje proceduralo-penale me shkrim në mes të palëve.

Qëllimi i këtij Projektligji është sigurimi i një baze ligjore për futjen e një instituti të ri juridik në Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, mbi pranimin e fajësisë i cili është shumë i rëndësishëm dhe ekziston në të gjitha kodet e procedurës penale të shteteve më të zhvilluara

Projektligji rregullon dhe qartëson në mënyrë të detajuar kushtet dhe kriteret për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, si dhe të drejtën e revokimit apo të heqjes dorë nga

ajo nën kushtet e parapara me këtë Kod, pastaj përcakton qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e Gjykatës, të Prokurorit dhe të të akuzuarit, përkatësisht të mbrojtësit të tij.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Bajram Kosumi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupi Parlamentar “7+”, **Müfera Şinik**, si dhe deputetët: **Hydajet Hyseni**, **Hajdin Abazi**, **Gani Buçinca**, **Gani Koci**, të cilat janë dhënë në transkript.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për procedurën kontestimore.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se Projektligji për procedurën kontestimore është një projektligj i cili cakton rregulla procedurale në bazë të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjedhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko civile të personave fizik dhe juridik. Projektligji shikuar nga përmbajtja dhe vëllimi i tij paraqet një ligj të rëndësishëm dhe voluminoz në aspektin e rregullave juridike për zgjedhjen e kontesteve civile të karakterit kontestues.

Nevoja për këtë projektligj është e madhe pasi që Kosova po kalon në një ekonomi të tregut të lirë ku edhe rregullat juridike për zgjidhjen e kontesteve civile duhen t’i përshtaten rrethanave të krijuara.

Implementimi i këtij projektligji nuk krijon implikime buxhetore pasi që nuk kërkon krijimin e ndonjë organi të ri apo ndonjë strukture tjetër organizative.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobrdaliu**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, të cilat janë dhënë në transkripto.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbarese

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për procedurën përmbarese.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se ky Projektligj rregullon procedurën e përmbarimit (ekzekutimit) të vendimeve të gjykatave civile. Projektligji nga përmbajtja

dhe vëllimi i tij paraqet një materie shumë të rëndësishme dhe voluminoze në aspektin e rregullave juridike që kanë të bëjnë me përmbarimin e vendimeve të gjykatave civile.

Ky projektligj është i rëndësishëm, pasi që Kosova po kalon në një ekonomi të tregut të lirë, ku edhe rregullat juridike për përmbarimin e vendimeve të gjykatave civile duhen t'u përshtaten rrethanave të krijuara.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selvie Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobërdaliu**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, dhe në emër të Grupi Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, të cilat janë dhënë në transkript.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se me këtë projektligj synohet të vendoset një kornizë adekuate ligjore që ka për qëllim deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Ky projektligj ka rëndësi të veçantë sepse me anë të tij krijohet infrastrukturë ligjore që deri më tani ka munguar në legjislacionin tonë.

Me anë të këtij Projektligji obligohen të gjithë zyrtarët e lartë publikë të deklarojnë pasurinë e tyre, me rastin e punësimit në shërbimin publik, gjatë ushtrimit të pozitës së tyre si zyrtarë dhe pas largimit të tyre nga funksioni publik. Qëllim tjetër i këtij projektligji është sanksionimi i të gjithë zyrtarëve të lartë publikë për mosdeklarimin eventuale të pasurisë së tyre.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Gashi**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, të cilat janë dhënë në transkript.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se plotësimet e bëra me këtë projektligj janë të një rëndësie të veçantë ngase me plotësimet dhe ndryshimet e tilla synohet të vendoset një kornizë adekuate ligjore për përmirësimin dhe avansimin e kushteve që kanë të bëjnë me personat e dënuar, si dhe përshtatjen e tyre me standarde evropiane dhe ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij projektligji është sigurimi i një baze ligjore, që do të mundësojë risocializimin e të gjithë të dënuarve, përgatitjen e tyre për jetë dhe sjellje të ndërgjegjshme, si dhe mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, dhe të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobrdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Donika Kada**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Hydajet Hyseni – Kaloshi**, **Ibrahim Makolli**, **Gani Buçinca**, **Ardian Gjini**, të cilat janë dhënë në transkript.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokontestimore

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për procedurën jokontestimore.

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se me këtë projektligj caktohen rregullat procedurale sipas të cilave gjykatat veprojnë dhe vendosin mbi të drejtat dhe interesat personale, familjare dhe pasurore që zgjidhen në procedurën jokontestimore.

Projektligji është i rëndësishëm pasi ofron zgjidhje të reja procedurale shumë më praktike dhe më efikase për gjykatat në drejtim të vendosjes për të drejtat dhe interesat personale familjare dhe pasurore.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Suzan Novobërdaliu**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, të cilat janë dhënë në transkript.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

Kryesuesi ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, tha se qëllimi i këtij Projektligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Nevoja për nxjerrjen e projektligjit është që të sigurohet korniza ligjore për shfrytëzimin më efikas të mjedisit dhe të resurseve natyrore, si dhe forcimi i përgjegjësisë për zhvillimin e vet, harmonizimin me direktivat e BE-së, ku do të përcaktohen kushtet, mënyra dhe procedurat e vlerësimit, të ndikimit të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selvije Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Donika Kada**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Etem Arifi**, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryesuesi dha pauzë për drekë, në orën 14:00.

Seanca i vazhdoi punimet në orën 16:00 me votimin e projektligjeve të shqyrtuara paradite.

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----73,
Kundër-----2,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës..** Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 74;
Kundër----- 2.
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penal të Kosovës brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për procedurën kontestimore**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 79;

Kundër----- 0.

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për procedurën kontestimore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për procedurën kontestimore brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për procedurën përmbaruese**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69;

Kundër----- 0.

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për procedurën përmbaruese.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si Komision Funksional dhe Raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjit për procedurën përmbaruese brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 80;

Kundër----- 0.

Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si Komision Funksional dhe Raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta

shqyrtojnë Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 79;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për procedurën jokontestimore**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76;
Kundër----- 1.
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për procedurën jokontestimore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për procedurën jokontestimore brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 78;
Kundër----- 1.
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe planifikim Hapësinor – si komision funksional dhe raportues, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisioni për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e sotme në orën 16:25 minuta

E enjte, 28 shkurt 2008
Vazhdim i seancës

Në fillim seancën e kryesoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 66 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcillar**, tha se ky projektligj është i nevojshëm për të rregulluar procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar.

Qëllimi i këtij projektligji është që të bëjë parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis të projekteve të propozuara nga aplikuesi, që do të thotë se personi juridik për realizimin e projektit konkret duhet të kërkojë pëlqimin mjedisor.

Projektligji është i strukturuar në gjashtë kapituj dhe tri shtojca, në të cilat parashihen: dispozitat e përgjithshme, qëllimi, lënda e rregullimit, përkufizimet dhe emërimi i autoritetit kompetent, projektet që i nënshtrohen VNM-së, procedurat e VNM-së, rregullat për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut, dispozitat ndëshkuese dhe të kundërvajtjes dhe në fund dispozitat përfundimtare dhe kalimtare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selvi Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Eset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së **Donika Kadaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj**, dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, si dhe deputetët: **Et’hem Çeku**, **Bahri Hyseni**, **Hajdin Abazi**, të cilat janë dhënë në transkript.

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj** tha se arsyet kryesore që kanë ndikuar për ta ndryshuar dhe plotësuar e ligjin në fuqi për skemën Sociale janë: përkufizimi dhe qartësimi i drejtë i disa shprehjeve dhe nocioneve të përdorura në këtë ligj e më hershëm, përcaktimi i kriterëve të reja për përfituesit e ndihmave sociale, eliminimi i disa kriterëve financiarë për ndihma sociale të cilat nuk kanë qenë në, dhe përllogaritja e pensioneve

bazë, të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara dhe të pensioneve të luftës si të hyra materiale të llogaritura me rastin e përzgjedhjes së familjes si përfitues i ndihmës sociale.

Qëllimi themelor i projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale është avancimin e rrjetit të mbrojtjes sociale për familjet e përzgjedhura në skemën e ndihmës sociale në Kosovë, përkatësisht për familjet përfituese.

Me këtë projektligj parashihen të kursehen nga buxheti i Kosovës në deri në 3.321.756 euro.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Teuta Hadri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Qamile Morina**, dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, si dhe deputetët: **Flora Brovina**, **Ahmet Isufi**, **Hajdin Abazi**, **Gani Buçinca**, **Vezira Emrush**, **Ardian Gjini**, **Driton Tali**, **Selvije Halimi**, **Ibrahim Makolli**, **Esat Brajshori**, **Kaçusha Jashari**, **Lutfi Haziri**, **Ramë Buja**, **Naim Maloku**, **Gani Geci**, **Adem Salihaj**, **Sadik Idriz**, **Bahri Hyseni**, **Gjylnaze Syla**, **Agim Veliu**, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit.

19. Shqyrtimin e parë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Idriz Vehapi** tha se aktualisht në Kosovë është në fuqi Ligji për Inspektoratin e Punës nr: 2002/9, mirëpo për shkak të mangësive dhe të paqartësive në këtë ligj është paraqitur nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Me këtë projektligj eliminohen paqartësitë në rolin e ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësisë të Agjencisë Ekzekutive të Inspektoratit të Punës në të gjitha nivelet, por edhe do të ndikoj pozitivisht në rritjen e bashkëpunimit dhe të sinkronizimit të punëve dhe detyrave të punës me qeveritë komunale, inspektoratet e tjera, me autoritetet e tjera relevante dhe me Shërbimin Policor të Kosovës.

Projektligji rregullon fushëveprimin e Agjencisë Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, si vijon: qartësimin dhe konkretizimin e funksioneve të Agjencisë, rregullimin dhe përcaktimin e përbërjes dhe mënyrat e emërimit të stafit drejtues, definimin dhe përcaktimin e autorizimeve për kryeshefin e Agjencisë, të zëvendësve të tij dhe të inspektorëve të punës, si dhe çështjen procedurave administrative të ankimit. Projektligji nuk paraqet implikime buxhetore.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Mimoza Ahmeti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nurishahe Hulaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Shkëmbim Demaliaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Idriz Sadik**, të cilat janë dhënë në transkript.

20. Shqyrtimi i parë të Projektligjit për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Idriz Vehapi** tha se nevoja për projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, ka rrjedhe si pasojë e mungesës së legjislacioni për mbrojtjen dhe përkrahjen e personave nën moshën 18 vjeçare.

Projektligji ka për qëllim zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjitha familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme në mënyrë që t’ju mundësohet këtyre fëmijëve të bëjnë një jetë normale dhe më dinjitoze.

Projektligji është i strukturuar në shtatë kapituj në të cilët parashihen: dispozitat themelore, realizimi i të drejtës në ndihmë materiale, komisioni i ekspertëve për vlerësimin dhe kategorizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, procedura për ekspertizë, mjetet financiare për zbatimin e ligjit, parashtrimi i kërkesës, vendosja, dhe dispozitat kalimtare.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Flora Brovina**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sanije Aliaj**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Qamile Morina** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, si dhe deputetët: **Driton Tali**, **Gjylnaze Syla**, **Armend Zemaj**, **Hajdin Abazi**, të cilat janë dhënë në transkript.

21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, tha se Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, ka arritur si nevojë e krijimit të

kushteve ligjore për rregullimin e çështjes së banesave për të cilat është e themeluar e drejta banesore, për të gjithë qytetarët e Kosovës, në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese.

Ky projektligji, përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrën e shitjes së banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës, si dhe mënyrën e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarjen e të drejtës banesore.

Projektligji është i sistemuar në 7 kapituj dhe 47 nene dhe ka ndarë në mënyrë të qartë kompetencat ndërmjet institucioneve për procedurën e shitjes dhe ka paraparë afatet, si dhe rregullon mënyrën e shpërndarjes së mjeteve të realizuara nga shitja e banesave.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Zef Morina**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Ibrahim Gashi**, **Vezira Emrush**, **Kaqusha Jashari**, **Berim Ramosaj**, **Ismet Beqiri**, **Driton Tali** dhe **Bahri Hyseni**, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryesuesi dha pauzë për drekë, në orën 14:00.

Seanca i vazhdoi punimet në orën 16:00 me votimin e projektligjeve, të shqyrtuara paradite.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----71,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor- si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----19,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqene Sociale- si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----9,
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqene Sociale, si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----77,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqene Sociale- si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete, që ta shqyrtojnë Projektligjin për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----10,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

E premte, 29 shkurt 2008 **Vazhdim i seancës**

Seancën e kryesoi **Jakup Kasniqi**, Kryetar i Kuvendi, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 71 deputetë.

22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ushqimin

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për ushqimin.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Idriz Vehapi**, tha se qëllimi i projektligjit është krijimi i kornizës ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me higjienën, sigurinë e ushqimit për shëndetin publik dhe ushqimit të sigurt për kafshë, që do të mundësonte arritjen e objektivave të përgjithshme për një siguri më të madhe të qytetarëve të Kosovës.

Zbatimi i këtij ligji në pjesën më të madhe të tij nuk ka implikime financiare që do ta ngarkonin Buxhetin e Kosovës, pasi që organet e parapara që të themelohen tash ekzistojnë dhe edhe ashtu varen nga Buxheti i Kosovës si fjala vjen Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit i Kosovës është themeluar me Ligjin për Veterinarinë.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Teuta Hadri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nurishahe Hula**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Arsim Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idri**, si dhe deputetët: **Alush Gashi**, **Armend Zemaj**, **Riza Smaka**, **Naim Maloku**, **Lulzim Zeneli**, **Gani Koci**, **Gjylnaze Sylaj**, të cilët janë dhënë në transkript.

23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Enver Hoxhaj**, tha se ky Projektligj rregullon mënyrën e organizimit, përmbajtja, kushtet, kriteret dhe procedura e provimit përfundimtar dhe të maturës në Kosovë.

Në bazë të vlerësimeve, kostoja buxhetore do të mbulohet nga të hyrat që realizohen nga participimi në pagesat për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Agim Veliu**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Vlora Çitaku**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Arsim Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Rasim Selmanaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Dritë Maliqi**, si dhe deputetët: **Ibrahim Gashi**, **Armend Zemaj**, **Adem Hajdaraj**, **Luljetë Shehu**, **Adem Salihaj**, **Memli Krasniqi**, **Mark Krasniqi**, **Myrvete Pantina** dhe **Riza Smaka**, të cilët janë dhënë në transkript.

24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rehabilitim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për rehabilitim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Zëvendës kryeministri, **Ramë Manaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se qëllimi i këtij projektligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për rehabilitim, aftësim profesional dhe nxitjen e punësimit të përshtatshëm për persona me aftësi të kufizuara.

Me këtë projektligj rregullohen dhe përcaktohen të drejtat, kushtet, mënyrat e rehabilitimit profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Flora Brovina**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sanije Aliaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Njomëza Emini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, të cilët janë dhënë në transkript.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

25. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, tha se qëllimi i këtij projektligji është të rregulloj sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut.

Projektligji do të ketë implikime buxhetore për vitin 2008-2009, sipas vlerësimeve përafërsisht 425.500 €.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selvie Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Donika Kada**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, të cilët janë dhënë në transkript.

26. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Ministri për Tregti dhe Industri, **Lutfi Zharku**, tha se qëllimi i këtij projektligji është vendosja dhe përmirësimi i kornizës themelore legjislative, duke përfshirë klasifikimin e ndërmarrjeve, funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Projektligji parasheh implikime buxhetore me formimin e Këshillit të Agjencisë si organ drejtues.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Kaçusha Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Et’hem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Blerim Ramosaj**, të cilët janë dhënë në transkript.

27. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **Idriz Vehapi**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, në rastet kur kryhet lirimi i qëllimshëm i organizmave të modifikuar gjenetik në mjedis, dhe kur vendosen në treg prodhimet të cilat përmbajnë apo konsistojnë nga organizmat e modifikuar gjenetik.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Blerim Ramosaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, të cilët janë dhënë në transkript.

Seanca i vazhdoi punimet në orën 16:00

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë tani 74 deputetë.

Seanca i vazhdoi punimet në orën 16:00 me votimin e projektligjeve, të shqyrtuara paradite.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjin për ushqimin**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për ushqimin.

Kuvendi ngarkoi Komisioni për Bujqësi, Mjedis dhe planifikim Hapësinor – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për Ushqimin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për provimin përfundimtar dhe të maturës**. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 72;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës.

Kuvendi ngarkoj Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - si komision funksional dhe raportues si dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për provimin përfundimtar dhe të maturës brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara**. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 72;
Kundër----- 0.
Abstenime-----0

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim Projektligjin për rehabilitim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit**. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 68;
Kundër----- 0.
Abstenime-----2

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit.

Kuvendi ngarkoj Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, dhe Komisionin për Komunitete, që ta shqyrtojnë Projektligjin për mbrojtjen e mjedisit brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 71;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi në parim, projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport - si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, dhe Komisioni për Komunitete, që ta shqyrtojnë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht**. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 70;
Kundër----- 1.
Abstenime-----2

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Kuvendi ngarkoj Komisioni për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, dhe Komisioni për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

E hënë, 3 mars 2008 **Vazhdim i seancës**

Seancën e kryesoi **Jakup Kasniqi**, Kryetar i Kuvendi, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 67 deputetë.

28. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën e vendosjes

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për taksën e vendosjes.

Ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, **Lutfi Zharku** tha se Projektligji për taksën e vendosjes luan një rol të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të turizmit dhe politikave zhvillimore në Kosovë.

Me këtë projektligj do të rregullohet taksa e vendosjes për shërbimet e ofruara nga ana e objekteve turistike dhe hoteliere, të cilin e paguan personi i cili shfrytëzon shërbime të vendosjes. Taksa e vendosjes propozohet të jetë në lartësi prej 0.50 deri në 1.50 euro për person, në varshmëri nga çmimi i fjetjes. Ligji përcakton edhe kategoritë, të cilat janë të liruara nga pagesa e kësaj takse, siç janë: fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, personat në rehabilitim mjekësor, invalidët e luftës, si dhe kushtet për shfrytëzimin e këtij lirimi.

Projektligji parasheh që shfrytëzimi i mjeteve të grumbulluara nga taksa e vendosjes të përcaktohet me akte nënligjore.

Projektligji përmban edhe dispozita ndëshkimore lidhur me zbatimin e tij.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për taksën e vendosjes dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hajdin Abazi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Kolë Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejeme Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevat Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Berim Ramosaj** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha**, si dhe deputetët: **Mimoza Ahmetaj**, **Driton Tali**, **Riza Smaka** dhe **Gani Buçinca**, të cilat janë dhënë në transkript.

29. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.

Zëvendëskryeministri, **Hajredin Kuçi** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e domosdoshme, ngase Ligji për tokën ndërtimore i vitit 1980, i plotësuar në vitin 1986 ka pasur një disproporcion me ndryshimet juridike dhe ekonomike që i ka Kosova sot.

Me këtë projektligj caktohen normat për rregullimin e tokës ndërtimore, për kushtet, mënyrën dhe procedurën e privatizimit, si dhe rregullat për dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës, në bazë të të cilave titullarët i realizojnë këto të drejta dhe detyrime pronësore-juridike përmes institucioneve kompetente të Kosovës.

Me këtë projektligj krijohet infrastrukturë ligjore e harmonizuar me standardet ndërkombëtare për rregullimin e tokës ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore. Veçanërisht, ka ndikim në sigurinë dhe përshtatjen e investimeve të huaja në sfera të ndryshme ekonomike, siç janë: në fushën e ndërtimit urban, në mbrojtjen e ambientit dhe planifikimin hapësinor.

Shpenzimet për zbatimin e këtij ligji mund të mbulohen dhe të tejkalohen me të hyrat që krijohen nga procesi i privatizimit i tokës dhe i dhënies së saj me qira.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Nerxhivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Zef Morina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smakaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Sanije Aliaj**, **Berat Luzha** dhe **Shkumbin Demaliaj**, të cilat janë dhënë në transkript.

30. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin për Inspeksionin bujqësor.

Ministri i Shërbimeve Publike, **Arsim Bajrami**, tha se ky projektligji është i një rëndësie të madhe, sepse një ligj i tillë i duhet Kosovës për ta ruajtur jetën dhe shëndetin e njerëzve, të kafshëve dhe përgjithësisht shëndetin publik.

Projektligji ka për qëllim krijimin e kornizës të domosdoshme ligjore për inspektimin e fushave me sa vijon: të bujqësisë, të pylltarisë, të gjuetisë, të mbrojtjes së bimëve, të blegtorisë, të peshkatarisë dhe të veterinarisë.

Projektligji ka një strukturë komplekse dhe përmbajtjesore që përbëhet prej 7 kapitujve dhe është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore në harmoni me standardet e bashkimit evropianë.

Me këtë projektligj rregullohet organizimi i Inspektionit bujqësorë, i cili është organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe kompetent për realizimin e inspektionit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Të drejtat, detyrimet dhe autorizimet e Inspektionit janë përcaktuara qartë. Projektligji rregullon bashkëpunimin e Inspektionit bujqësorë qendrorë me inspektionin lokal.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e këtij Projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për Inspektionin bujqësor dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, **si dhe deputetët: Nurishahe Hulaj, Riza Smaka dhe Sanije Aliaj**, të cilat janë dhënë në transkript.

Në fund të debatit, zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** i falënderoi deputetët për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna. Ai u premtoi deputetëve se vërejtjet do t’i marrim parasysht dhe lëshime të bëra deri me tani do t’i përmirësojnë gjatë hartimit të legjislacionit.

Ai tha se Qeveria në Strategjinë legjislative për këtë vit ka paraparë rreth 175 ligje. Por, kjo strategji është evolutive. Shumë shpejt me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, përveç të autorizuarve të deritanishëm për nisma ligjore edhe qytetarët e Kosovës, me një numër të caktuar të nënshkrimeve, mund të marrin nisma ligjore dhe besojmë që këtë vit rreth 200 ligje do t’i miratojmë në Kuvendin e Kosovës për të ndërtuar infrastrukturë legale, që përputhet me shtetin e Kosovës dhe me integrimet evropiane.

Kryesuesi dha pauzë 30 minuta.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Të pranishëm ishin 76 deputetë.

Seanca vazhdoi punimet me votimin e projektligjeve, të shqyrtuara para dite.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për taksën e vendosjes**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për taksën e vendosjes.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Tregti dhe Industri – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi , Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për taksën e vendosjes brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----75,
Kundër-----1,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të saj.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi , Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të saj, brenda dy muajve, dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e **Projektligjit për Inspeksionin bujqësor**. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----77,
Kundër-----0
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Inspeksionin bujqësor.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi , Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë Projektligjin për Inspeksionin bujqësor, brenda dy muajve, dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale